

Mora dy kopje te vendimit dhe te Lejes

dat - 19.08-2008

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE



V E N D I M

Nr. 3 Date 08 Gusht 2008

“PER
MIRATIMIN E LEJES PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE”.

Bazuar ne piken 9 kreu XI “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates “, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt 19.01.2007 te K.M., “ “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, me propozim te A.U.B. Drin- Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune Shkoder

V E N D O S I :


- 1- MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore: Perroi i Cajes & Perroi i Buzemadhit , (Ura e Lapajve), Komuna Bushtrice, Qarku Kukes, per prodhim hidroenergjie, bashkimit te perkohshem te Shoqerive “SPAHIU - GJANC “ Sh.p.k., “ FATJON “ Sh.p.k., “ S.G.A.” Sh.a. dhe “ ARMEMIL “ Sh.p.k. te cilet kane nenshkruar Kontraten e Koncesionit, me autoritetin Kontraktues me date 28 Mars 2008, bazuar ne miratimin e marre me V.K.M.-ne nr. 432 dt. 08.04.2008, dhe kane depozituar prane A.U.B. Drin-Bune kerkesen e kopjen e noterizuar te Kontrates se Koncesionit per HEC “LAPAJ “ qe do te ndertojne.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore Perroi i Cajes & Perroi i Buzemadhit (Ura e Lapajve), per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PERGJEGJESI I A.U.B.

DRIN-BUNE

Osman DELTINA

Ing. Osman DELTINA



KRYETARI I K.B.U.

DRIN-BUNE

Maxhid CUNGU

Maxhid CUNGU

